

Komunikatë për udhëtimin në qytetin e Nju-Jorkut

Mirë se vini në qytetin e Nju-Jorkut!

Shteti i Nju-Jorkut ka nxjerrë një komunikatë për udhëtimin për udhëtarët që vijnë nga shtete të SHBA-së me shkallë të konsiderueshme përhapjeje të COVID-19 në komunitetin e gjerë.

Në përputhje me komunikatën, legjislacioni i shtetit të Nju-Jorkut kërkon që nëse udhëtoni këtu nga shtete me nivel të lartë infektimi me COVID-19, keni për **detyrë** të zbatoni udhëzimin e mëposhtëm shtetëror, përndryshe mund të merrni \$2,000 gjobë.

Sipas legjislacionit shtetëror

Nëse udhëtoni këtu nga cilido prej këtyre shteteve DHE

Keni kaluar më shumë se 24 orë në atë shtet, keni për detyrë të ndiqni udhëzimin e mëposhtëm.

Udhëzim shtetëror:

1. Karantinohuni dhe veçohuni nga të tjerët për t'i mbajtur të gjithë të sigurt. Jeni të lutur të qëndroni në shtëpinë tuaj apo në vendin ku banoni përveç nëse keni raste emergjence apo kërkonijë kujdesin mjekësor për 14 ditë nga largimi nga vendi i nisjes.
2. Plotësoni këtë formular të shëndetit të udhëtarëve në faqen traveler.health.ny.gov ose skanoni kodin e mëposhtëm.



3. Shqyrtoni përgjegjësitë tuaja të mëtejshme sipas komunikatës për udhëtimin. Mund të ketë përjashtime për kategoritë thelbësore të punonjësve që udhëtojnë drejt Nju-Jorkut. Vizitoni ny.gov/traveladvisory.

Nëse ju duhet mbështetje kur jeni në karantinë, NYC Test & Trace Corps mund t'ju ndihmojë të veçoheni në mënyrë të sigurt në shtëpi apo në një hotel privat falas. Keni pyetje? Telefononi linjën direkte NYC COVID-19 në nr. **1-877-CVD-19NY (1-877-283-1969)**.

Këto janë shtetet që plotësojnë kriteret për karantinën e kërkuar **që nga** . Vizitoni ny.gov/traveladvisory për listën më të përditësuar.

. Kjo listë ndryshon rregullisht.

Lufto COVID-19 në NYC!

TESTIM




Mësoni gjendjen tuaj. Merrni teste falas të COVID-19 dhe të antitropave.

GJURMIM



Përgjigjuni thirrjes së gjurmuesve tanë të kontakteve për të ndihmuar ndalimin e përhapjes së COVID-19 në komunitetin tuaj.

PËRKUJDESJE



Veçohuni në mënyrë të sigurt për të mbrojtur të tjerët dhe merrni përkujdesje në hotel apo në shtëpi.

Keni pyetje? Telefononi linjën direkte NYC COVID-19 në nr. 1-877-CVD-19NY (1-877-283-1969).

NYC Test & Trace Corps është i përkushtuar në mbrojtjen e privatësisë dhe të sigurisë së informacionit tuaj personal dhe shëndetësor. I gjithë informacioni është konfidencial dhe i mbrojtur sipas Kodit Shëndetësor të qytetit të Nju-Jorkut. Test & Trace Corps nuk do të pyesë për statusin e imigrimit të askujt.

Albanian 08/20

NYC
HEALTH+
HOSPITALS

**Test & Trace
Corps**